



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA OBILIQ - OPŠTINA OBILIĆ - MUNICIPALITY OBILIC

Nr. Br. No.

01-060-01-13851-24

Nr. i fq. / Br. str. / No. pg

1-7

Data / Datum / Date

16.05.2024

OBILIQ - OBILIĆ - OBILIC



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO  
KOMUNA E OBILIQIT  
OPŠTINA OBILIĆ - MUNICIPALITY OF OBILIC

KUVENDI KOMUNAL OBILIQ

Skupština Opštine Obilić - Municipality Assembly Obiliq

EKSTRAKT I PROCESVERBALIT

Nga mbledhja e Kuvendit komunal, të mbajtur me dt.30.04.2024, në orën 11:00, në sallën e Kuvendit komunal.

**Të pranishëm ishin këta anëtarë:** Enver Gashi (IQO), Shaip Paloja (IQO), Labinot Mirena (IQO), Vlora Mjekiqi Kabashi (IQO), Jeton Mjekiqi (IQO), Nazlije Shala (IQO), Florije Jashari (IQO), Lulzim Preniqi (IQO), Fidan Ahmeti, (IQO), Sami Ahmeti (LVV), Ajshe Haliti Pllana (LVV), Albanë Shillova Shalaku (LVV), Valon Svirca (LVV), Ajet Berisha (LB), Valbonë Beka (LB), Linda Sadiku Krasniqi (LDK), Bajram Hashani (LDK), Xhelal Krasniqi (AAK), Samire Berisha (PDK), Ratomir Ristic (SL) dhe Biljana Spasic (SL).

**Të pranishmit tjerë:** Ibush Mjekiqi, Nënkryetar i Komunës, drejtorët komunal, Burim Gërguri, shef i kabinetit të Kryetarit, banorët e fshatit Shipitullë, përf.e OSBE-së dhe përf. e KFOR-it  
Mbledhjen e udhëhoqi Vlora Mjekiqi Kabashi, kryesuese e cila pasi konstatoi se ka kuorum filloi mbledhjen me këtë:

R E N D I T E

1. Arsytimi për mungesë
2. Miratimi i ekstraktit të procesverbalit nga mbledhja e kaluar
3. Shqyrtimi i Raportit financiar të shpenzimeve për periudhën janar - mars 2024, dhe Raportit për subvencionet sipas Drejtorive
4. Shqyrtimi i Raportit vjetor të NPL "Kastrioti" SH.A. për vitin 2023
5. Shqyrtimi i kërkesës për ngritje të tarifës për shërbimet e menaxhimit të mbeturinave
6. Shqyrtimi i kërkesave
7. Të ndryshme

**Kryesuesja** – I njoftoi të pranishmit me rendin e ditës, i cili u miratua me 20 vota për.

**Pika 1 e rendit të ditës**

Të gjithë anëtarët ishin të pranishëm.

**Pika 2 e rendit të ditës**

Miratohet ekstrakti i procesverbalit nga mbledhja e kaluar me 20 vota për.

**Pika 3 e rendit të ditës**

**Kryesuesja** – Paraqiti shqyrtimin e Raportit financiar të shpenzimeve për periudhën janar – mars 2024 dhe raportin për subvencionet sipas Drejtorive.

**Enver Gashi** – Ne si grup raportin financiar e kemi shqyrtuar dhe nuk kemi ndonjë vërejtje. Buxheti është duke u shpenzuar mirë dhe kemi një performancë të mirë, kështu që besoj se ky vit do të jetë edhe më i mirë, e kemi kaluar mbi 90 % dhe ju uroj vetëm suksese.

**Sami Ahmeti** – Po në fakt edhe ne e kemi lexuar raportin që në pamjen e parë të jepë përshtypjen e një dokumenti statistikor, por jo më shumë. Sido që të jetë te investimet kapitale fokusi dhe i vetmi investim deri më tani është pjesa e kogjenerimit. Asnjë prej listave të tjera, do të thotë që janë të listuara nuk ka asnjë harxhim edhe pse ka qenë një mot i mirë dhe nuk ka pasë asnjë telashe për me ekzekutue diçka. Prej krejtë investimeve kapitale janë harxhuar 3 milionë e 770 mijë euro, te kogjenerimi dhe kaq thjeshtë statistika pa asnjë shpjegim. Ky raport normal po më duket shumë i varfër edhe fokus i këtij Ekzekutivi po duket të kenë vetëm tenderët e mëdhenj, por jo edhe ato gjëra të cilat kanë fokus jetën e përditshme të qytetarëve. Edhe te subvencionet nuk është raport, është një dokument i thjeshtë statistikor i subvencioneve dhe aty ku duhen janë subvencione shumë të ulëta, e atyre që nuk plotësojnë asnjë kusht shumë të larta. Kështu, po më duket mua si raport dhe unë e di që ky raport nuk votohet, gjithsesi mirë që raportohet por si raport mua më duket shumë i varfër.

**Ajet Berisha** – Unë po pyes se bursat për studentët dhe nxënësit e vitit 2023 po paguhen në vitin 2024, do të thotë buxheti ndahet për vit 1 janar – 31 dhjetor, pse po raportohet për ato të vitit 2023 tash subvencion. Këtë nuk po mundem me kuptue qe 2 vite, me rend kështu po ndodhë. Bursat që ndahen në tetor të vitit 2023 po paguhen në mars të vitit vijues, qysh po ndodhë kjo sepse në aspektin financiar dhe buxhetor nuk po mundem me kuptue.

**Nënkryetari i Komunës** – Përgjegjet po është e vërtetë se paguhen me buxhet të këtij viti meqenëse, procesi i ndarjes së bursave dhe udhëtimit po merrë kohë, duke ditur se buxheti shpenzohet deri me 20 dhjetor 2023 atëherë, gjithmonë paguhen në fillim të vitit vijues. Buxheti i paraparë për këtë vit veç është shpenzue dhe deri më tani dikund rreth 300,000 euro kanë shkue në bursa, shpenzime të udhëtimit e tjera. Me këtë buxhet raportohet sepse viti shkollor llogaritet prej 1 shtatorit deri me 30 qershor, do të thotë nuk përkon me vitin fiskal por me vitin shkollor.

**Ajet Berisha** – Pyeti qysh po lejohet.

**Nënkryetari i Komunës** – Lejohet sepse është i paraparë buxheti për këtë punë

**Ajet Berisha** – Proceduralisht vendimi po merret për vitin 2023, ndërsa pagesat po ndodhin në vitin 2024, qysh po bëhet kjo mundësi. Unë e di se për çdo vit ka bursa, por qysh ka mundësi vendimi i vitit 2023 të bartet në vitin 2024 kur tash edhe të hyrat vetanake po i tërheqin.

**Nënkryetari i Komunës** – Procesi i përzgjedhjes së të gjitha lëndëve të cilët aplikojnë vërtetë, është një punë voluminoze dhe merrë kohë. Më duket se u sqaruar, nuk paraqet problem as për vit fiskal, as për vit shkollor. Ne këtë vit i kemi krye obligimet që i kemi ndaj studentëve dhe nxënësve për udhëtim, kështu që është duke rjedhë mirë ky proces sepse viti shkollor nuk përputhet me vitin fiskal, këtë e dijme të gjithë dhe kjo është arsyeja.

**Kryesuesja** – Sqaron kjo bëhet për arsye se viti kalendarik mësimor është 2023-2024 dhe për atë lejohet dhe merret vendimi.

**Valbonë Beka** – Unë vetëm kisha dashur një sqarim të vogël te subvencionimi i lehonave, po i shohë se janë 13 meshkuj

**Nënkryetari i Komunës** – Sqaron se të dytë janë prindër edhe nëna, edhe babai, prandaj ka shkue në emër të babait.

#### **Pika 4 e rendit të ditës**

**Kryesuesja** – Paraqet shqyrtimin e Raportit vjetor të NPL “Kastrioti” SH.A. për vitin 2023.

**Enver Gashi** – NPL “Kastrioti” ka dorëzuar një raport që mendoj se është një raport i mirë. Është një e mirë se të gjitha punët e kësaj organizate shihen në terren dhe të gjithë banorët e Komunës, e prekun e shohin si dhe e kanë vlerësuar me një notë shumë të lartë punën e kësaj organizate. Unë iu uroj punë të mbarë me përkrahje sa më të madhe edhe të Komunës, që bashkë ta ndërtojmë, pastrojmë, regullojmë dhe shijojmë këtë Komunë çdo ditë.

**Şami Ahmeti** – Kushdo që e ka bërë raportin unë e falenderoj, është një raport bukur voluminoz. Ajo që mua më intereson te NPL “Kastrioti” është mirëqenia e punëtorëve të mirëmbajtjes që sipas të dhënave që i kemi kanë të ardhura shumë të vogla. Pra, përmirësimi i të ardhurave të tyre për dallim prej administratës, që kanë paga shumë më të mira, kjo më intereson përndryshe, nuk kam ndonjë vërejtje në raport

**Nënkryetari i Komunës** – Lidhur me pagat dihet se kush e rregullon pagën dhe po ashtu, edhe për shoqërinë aksionare dihet se kush e rregullon prandaj, unë mendoj se pagat i kanë në nivel të kompanive tjera, të cilat funksionojnë në bazëtë legjislativitetit që e rregullon këtë fushë. Paga nuk kemi aq të ulëta sa di unë jo duke krahasuar në raport me administratën sepse edhe në administratë janë disa punëtorë të cilët nuk i kanë pagat e larta, por këto janë pagat tani për tani. Në të ardhmen i takon edhe Bordit dhe operimit respektivisht balancit financiar se si ata operojnë dhe të krijojnë të hyra për me i rritë pagat e veta.

#### **Pika 5 e rendit të ditës**

**Kryesuesja** – Paraqiti kërkesën nga Drejtoria për mbrojtje të mjedisit për ngritjen e tarifës për shërbimet e menaxhimit të mbeturinave.

**Enver Gashi** – Ne edhe në mbledhjen e KPF-së, e kemi shqyrtue këtë temë dhe e kemi shqyrtuar edhe më heret. Kompania Pastrimi është kompani regjionale, që kryesisht këtë çmim e determinon Prishtina dhe ne i kemi disa lokalitete që vetëm vija administrative na ndanë, po them në Shkabaj janë shtëpitë e ngjitura ku njëra është me Prishtinën, e tjetra me Obiliqin. Të njejtën e kemi edhe në Dardhishtë me Fushë Kosovën, që është anomali me pague njëri fqj një çmim e tjetri një çmim tjetër. Për këtë arsye jemi që ky çmim të bëhet i njejtë me Prishtinën, të rregullohet të jetë i njejtë 6.2 pasi që veç jemi regjionale.

**Sami Ahmeti** – Referuar paraqitjes që po krahason Prishtinën, unë e kam krahasuar edhe Lipjanin dhe Fushë Kosovën, që fakturat e fundit të 3 këtyre Komunave, iu kanë ardhë nga 4.70 centë. Tani, kur është bërë ky ndryshim unë nuk e di dhe as ata ende nuk i kanë bërë këto ndryshime. Unë deshta vetëm pak një kronologji të kësaj Rregulloreje, me 26 tetor 2022 ne e kemi miratue këtë Rregullore, bazën kryesore të kësaj Rregulloreje në këtë Kuvend. Ne si asamblëistë të LVV-së, patëm propozuar disa ndryshime te kjo Rregullore, pikërisht te neni 6, pika 7, pika 10 dhe pika 20. Po ashtu, te neni 7, pika 1 i patëm propozue disa ndryshime. Kjo Rregullore si e tillë ka shkue në MAPL për aprovim dhe pas disa kërkesave të MAPL-së, për plotësim ndryshim me dt.28.02.2023 janë bërë ato ndryshime, që ka pasë të bëjë kryesisht me disa gjopa dhe lartësinë e tyre dhe e njehta Rregullore tash me nr.02//2023 dhe me nr.protokoli 1-22, e dt.1.3.2023, është publikuar në web faqen e Komunës me të gjitha vërejtjet dhe propozimet tona që ishin miratuar me dt.26.10.2022. Versioni i Rregullores që na keni propozuar vazhdon për të dytën herë me na ardhë pa këto ndryshime edhe pse janë miratue në Kuvend dhe mundem me iu dhënë komplet arsyetimet. Në kohën që e patëm miratue këtë Rregullore, aty patëm intervenue që edhe qytetarët ti realizojnë disa të drejta, që ti kenë disa të mira edhe për qytetarët. Pra, patëm kërkuar që të caktohet vendi i hudhjes së mbeturinave inerte dhe vendosja e atyre lloj kontejnerëve në vendbanime, që deri më tani nuk ka ndodhë. Patëm kërkuar dhe patëm miratuar propozimin që të vendoset orari publik kur mbledhen mbeturinat në secilën lagje dhe jo vetëm datat, por edhe ora e saktë që deri më tani nuk është bërë. Ende vazhdojnë të shpërndahen mbeturinat nga qentë endacakë sepse mbeturinat herë mbledhen në mëngjez, herë në mesditë, e nganjëherë edhe në mbrëmje, do të thotë nuk ka orar. Ne jemi dakorduar që mbeturinat e vëllimshme të mbledhen 6 herë në vit, do të thotë çdo 2 muaj papagesë dhe ende nuk është bërë një gjë e tillë. Po ashtu, patëm kërkuar që të gjithë gjeneruesit e mbeturinave të obligohen të kyqen në sistem, e jo të ngarkohen konsumatorët e ndershëm që vazhdimisht i paguajnë fakturat me tarifa shtesë për ata që nuk kyqen në sistem. Nëse, kjo do të bëhej mendoj se nuk do të kishte nevojë me rritë çmimin. Unë i ceka të gjitha këto, që të konkludojmë se ne nuk e kemi përmirësuar asnjë kusht të dakorduar ndërsa, ju po kërkonit të rritet tarifa nga 4.65 sa është në Rregullore në 6.20. Pra, po kërkonit rritje në kurriz të qytetarëve rreth 33 %. Sa i përket propozimit tuaj ne jemi kundër ndërsa, për prezentimin e Rregulloreve jozyrtare në këtë seancë unë do ti drejtohem MAPL-së, me një shkresë.

**Kryesuesja** – Sa i përket Rregullores, ka mund me ardhë që është gabim teknik nga Drejtoria, por ne e dërgojmë Rregulloren e cila është aprovuar nga Ministria përkatëse dhe e ndryshojmë siç është e potencuar vetëm te neni 10 dhe ajo qëndron e njehta me ato propozime që i keni paraqitë dhe aprovue ju. Është gabim

teknik që mundet me ndodhë sepse në detaje nuk e kemi shikuar Rregulloren dhe besoj se zyrtarët nuk e kanë shikuar, por e kanë bërë vetëm copy paste. Mirëpo, në MAPL dërgohet ajo që është aprovuar e fundit me protokol dhe është kërkuar të ndryshohet vetëm neni 10.

**Fidan Ahmeti** – Unë jam aksionar në kompaninë Pastrimi dhe duke pasë parasysh gjendjen financiare në të cilën gjendet kompania, mendoj se është shuma minimale 6.20 dhe ka shumë arsye se në internet 30 euro po e paguan, e mos ti llogarisim rastet se cilat janë. Kolegu Sami, që po kërkon me u rritë paga unë nuk e di qysh ka me u rritë nëse, nuk rriten të hyrat e kompanisë në këtë rast me kosto të çmimit. Për këtë arsye unë mendoj se është shumë e pranueshme rritja e çmimit të tarifës

**Ajet Berisha** – Unë duke mos hy te çmimi, kjo është dashtë me u bë njëfarë lloj studimi se sa është dashtë me qenë ky çmim, sa është dashtë me u rritë, arsyetimin pse është dashtë me u bë, cilat kosto nuk i mbulon çmimi aktual dhe sa ndikon në jetën e qytetarëve në tërësi. Kjo nuk i takon kompanisë sa ndikon në jetën e qytetarëve, por i takon Kuvendeve Komunale të aksionarëve. Në thelb unë jam kundër meqë, po bazohemi në një veprim të Kuvendit të Prishtinës, e jo në veprimin e kompanisë. Edhe në arsyetimin që na keni dhënë Komuna e Prishtinës e ka marrë një hap të tillë. Mendoj se kompania është dashtë me dalë me një studim i cili tregon se ky raport është i zhdrejtë varësisht nga puna sa bëhet dhe nga çmimi që paguhet me u arsyetue para secilit aksionar dhe para secilit Kuvend Komunal. Njëkohësisht në të gjitha Kuvendet Komunale duke pasë për bazë në kompaninë, e jo në njësi veç e veç me u bë këkesë në Kuvendet Komunale, në bazë të studimit që ky është një çmim përafërsisht real. Thuhet jo në Prishtinë ka ndodhë dhe a ka ndodhë në Lipjan, a ka ndodhë në Fushë Kosovë, cilat janë njësitë tjera, nuk e di është mirë njëkohësisht me u bë sepse disi ndjehen të diskriminuar në një kompani të njejtë që është regjionale në një Komunë me u rritë ndërsa, në Komunën tjetër jo. Do të thotë është jo reale dhe e njejtja vlerë është si në Obiliq, si në Fushë Kosovë atëherë, pse në Fushë Kosovë 4.70 centë e në Obiliq 6.20, kjo krijon pakënaqësi. Në rast se bëhet njëkohësisht unë isha pajtue dhe në rast se arsyetohet kjo 6.20 se ka me ndikue në të mirën e kompanisë, në zhvillimin e saj dhe në punën më të mirë që e kryejnë.

**Shaip Paloja** – Mos të merret se qëllimi është të dëmtohet qytetari i Obiliqit, por kostoja rritet që shërbimi ndaj qytetarëve të jetë shumë më i mirë. Ne jemi dëshmitarë se shumë shërbime që kryhen te ne, mund ta marrim me mend vetëm rryma sa është rritë dhe shumë gjëra tjera. Ne jemi dëshmitarë se këta punojnë me një teknologji shumë të vjetruar dhe pa të hyra qysh me përmirësue teknologjinë. U përmendë më heret orari dhe shpeshherë njoftohemi ne si qytetarë se ka ndryshue orari për shkak të prishjeve të ndryshme që i kanë në teknologjinë e tyre në automjete e shumë gjëra të tjera. Konsumatori në asnjë formë nuk është qëllimi këtu, të dëmtohet as qytetari por qëllimi i kësaj ngritje është që shërbimi të rritet dhe të jetë shumë më i mirë ndaj qytetarëve. Unë nuk pajtohem me parafolësin më heret konsumator i ndershëm dhe i pandershëm sepse mendoj se konsumatorë janë të gjithë të ndershëm, mundësitë secili nuk i kemi të njejtja, sido që të jetë ky është minimum i çmimit që duhet të jetë. Arsyeja e vetme është jo të dëmtohet qytetari, por shërbimi ndaj qytetarit të jetë shumë më i mirë.

**Abdyrrahman Krasniqi** – Sa i përket ngritjes së çmimit dhe disa tema që i ngriti z.Sami Ahmeti, pika bazë e rritjes së çmimit është sepse KMDK-ja, e ka rritë çmimin e deponimit, do të thotë 6 euro ka qenë e në këtë vit është rritë në 8 e 90 ndërsa, në vitin e ardhshëm pritet të bëhet 9 e 90. Është inflacioni që e ka përfshi krejtë botën, e jo vetëm Kosovën në këtë rast edhe Komunën tonë, janë karburantet që e kanë pasë një rritje të çmimit enorme, segmente kyçe për kompaninë Pastrimi e cila operon në regjion. E potencoi edhe z.Enver Gashi, se ne jemi pjesë e regjionit Prishtina veç e ka marrë këtë vendim në nëntor ose dhjetor të vitit të kaluar ndërsa Fushë Kosova këtë vendim e merrë sot, Obiliqi e merrë sot, Lipjani është pajtue për këtë vendim edhe Podujeva gjithashtu. Unë e njoftoj anëtarin e Kuvendit, se ka pasë njoftime dhe lehtësime në faqen e Komunës për deponimin e mbeturinave inerte për qytetarët e Komunës së Obiliqit, e cila ka qenë 3 herë e hapur gjatë vitit të kaluar. Ne planidikojmë edhe në këtë vit me i pasë të njejtja ku ka qenë deponimi falas në deponi. Këto, janë aksionet që i merrë Drejtoria e ambientit bashkë me Drejtorinë e shërbimeve publike dhe KRM Pastrimi qendra në Obiliq. Këto nuk janë tema që mund të futen në Rregullore, por janë aksione që në vazhdimësi Komuna duke i pa zhvillimet e projekteve të ndryshme i bën njoftimet dhe ka pasë përgjegje shumë të mirë prej qytetarëve në vitin e kaluar. Ne e mbështesim këtë

pritje dhe nëse e shohim mbulueshmërinë e anëtarëve në Komunën e Obiliqit, jemi ndoshta njësia shembull në këtë regjion

**Valbonë Beka** – Unë e kam një pyetje nëse, janë rritë çmimet që po ndikojnë si karburantet dhe tjerat që u përmendën, a nuk janë rritë edhe për biznese, apo vetëm për amvisëri që ka shkue rritja për amvisëri e te bizneset jo.

**Labinot Mirena** – Znj.Beka, janë rritë çmimet për biznese dikund para 5,6 muajve kur e kemi ndryshuar Rregulloren. Te puna e amvisërisë çmimi ka qenë pjesë sikurse në regjion se për biznese dallojnë çmimet me Komunën e Obiliqit dhe Komunën e Prishtinës. Në Prishtinë ka biznese që krijojnë mbeturina jashtëzakonisht shumë ndërsa, te ne bizneset munden me krijue mbeturina më pak. Te amvisëria shërbimi është derë më derë që ofrohet një herë në javë çmimi është 6 e 20 që ka punue Gizi gjerman dhe ka disa ekspertë të angazhuar në këtë çështje. Ajo që është kryesore është se ia vlen me falenderue menaxhmentin e kompanisë Pastrimi që është në qendër atje, Kryeshefin, drejtorin operativ që e kemi këtu prezentë që pagat e punëtorëve janë rritë për shkak të rrezikut të ikjes së punëtorëve jashtë vendit. Pagat e punëtorëve janë rritë dhe besoj punëtori i kompanisë Pastrimi tash është me pagë të dinjitetshme.

Pas diskutimeve, anëtarët e Kuvendit Komunal me 11 vota për 3 vota kundër dhe 6 vota abstenim morën Vendim për aprovimin e Rregullores (KO) nr.03/2024, e dt.30.04.2024 për plotësim ndryshimin e Rregullores (KO) nr.02/2023 për menaxhimin e mbeturinave në Komunën e Obiliqit.

**Nënkryetari i Komunës** – Kërkoj mirëkuptim prej juve sepse në ora 12:00 kemi me shkue në fshatin Siboc për homazhe dhe për momentin duhet ta ndërprejmë mbledhjen.

**Kryesuesja** – Të nderuar anëtarë të Kuvendit, në ora 13:00 vazhdojmë me mbledhjen.

Pas kthimit në ora 13:00 anëtarët e Kuvendit Komunal vazhdojnë mbledhjen.

#### **Pika 6 e rendit të ditës**

**Kryesuesja** – Ju njoftoj se nuk kemi asnjë kërkesë për shqyrtim në Kuvendin Komunal madje, as në Komitetin për Politikë dhe Financa nuk kemi pasë, kështu që kalojmë në pikën e radhës.

#### **Pika 7 e rendit të ditës**

**Kryesuesja** – Shpresoj se materialin e keni pranuar të gjithë bashkë me përgjegjen e KEK-ut, në lidhje me rekomandimin që e kemi nxjerrë për aprovimin e Peticionit të paraqitur nga banorët e fshatit Graboc. Pra, ne kemi këkuar në mënyrë urgjente nga KEK-u, që me bë zgjidhje me hap rrugën për Mirash sepse është e vetmja zgjidhje për banorët e këtyre 2 fshatrave. Ne kemi pranuar përgjegje nga KEK-u, me dt. 11.04.2024 për Kryetarin e Komunës nga Bordi i KEK-ut SH.A. Përveç rekomandimit të Kuvendit edhe Kryetari ka bërë kërkesë veçmas te Bordi i KEK-ut dhe ata janë përgjegjë. Pas një vlerësimi të plotë të situatës nuk është e mundur të miratohet kjo kërkesë për arsye të rëndësishme që ndërlidhen me sigurinë e banorëve dhe vazhdimësinë e operimeve të KEK-ut. Përkundër vullnetit të mirë për ti adresuar shqetësimet e banorëve përmes Peticionit dhe për të gjetur zgjidhje në kërkesën e tyre menaxhmeti i KEK-ut, e ka të pamundur realizimin e kërkesës duke marrë parasysh këta faktorë:

1. Siguria e pjesëtarëve të komunitetit, rruga për qarkullim duhet të siguroj një nivel të sigurisë për pjesëtarët e komunitetit. Projektimi i një rruge alternative përmes Mirashit për shfrytëzim publik sjellë shumë pasiguri.

2. Lëvizja e mekanizmave të rëndë, ndërhyrjet në hapësirat në terren dhe mekanizmat e rëndë kërkojnë një planifikim të hollësishëm dhe të specializuar.

3. Aktivitetet minerare dhe pasuritë natyrore kanë rëndësi sepse rruga e propozuar do të prekte këto aspekte në mënyrë të pamenduar dhe do të ketë ndikime negative në organizimin e aktiviteteve dhe në jetën e përditshme të banorëve

4. Pengesat në procesin e prodhimit sepse procesi i prodhimit do të jetë pengesë e vazhdueshme një rrugë e propozuar përmes Mirashit, do të krijoj pengesa logjistike dhe operative dhe furnizimin e rregulltë me qymyr për Termocentralet tona.

5. Segmenti prej trafostacionit Mirash deri te platoja e remonteve Bardh, rruga është pjesërisht e dëmtuar e vendeve e përfshirë nga rrëshqitjet lokale të shpatit jugor për shkak të gjeometrisë jo të rregulltë të shpatit jugor.

6. Palosja e brendshme është ende aktive, do të thotë nuk janë arritur kuotat përfundimtare të palosjes prej pjesës jugore trafostacion Mirash deri te dispeqeri në Mirash.

Bazuar në analizën tonë dhe përgjegjësisë tonë ndaj sigurisë, mjedisit dhe integritetit të komunitetit si dhe bazuar në Ligjin për Minjera dhe Minerale nr.03/L-163, licencës për operim dhe akteve tjera juridike, ne si menaxhment i korporatës nuk mund të miratojmë kërkesën për lejimin e hapësirës së rrugës përmes Mirashit për shfrytëzim publik në zonën e Mirashit.

**Enver Gashi** – Më duket si e kotë puna jonë me debatue 2 herë për të njejtën çështje. KEK-u, si një organizatë shtetërore është dashtë qysh në fillim para se me prish rrugën me iu bë zgjidhje qytetarëve të Grabocit dhe të një pjese të Shipitullës. Pra, nuk ka dashtë, nuk ka pasë njohuri, apo nuk ka pasë ekspertë nuk e di, por opcionin që e kanë kërkuar banorët e Grabocit përmes një Peticioni ne prapë e përkrahim, është i realizueshëm dhe nuk është aq i rrezikshëm. Unë e mbaj mend shumë mirë kur kemi kaluar nëpër KEK deri në Hade dhe kurrë asgjë nuk është bërë. Ajo pjesë andej që e bëjnë shumë tragjike rrëshqitjen e dheut, ata munden kohë pas kohe me i hedhë 2,3 kamionë zhavorr dhe nuk bëhet asgjë sepse është obligim i tyre, ai po i pengon banorët, e jo banorët KEK-un. Ne deri në fund, unë personalisht me gjithë grupin tim jemi që ky rekomandim të shkoj prapë për shqyrtim në të mirën e banorëve që jetojnë atje.

**Ajet Berisha** – Në takimin e kaluar biseduam rreth Peticionit dhe kërkesës që ishim unik që qytetarët ta shfrytëzojnë rrugën e Mirashit - Bardhë. Kishte me qenë shumë me interes se unë e kam parë që Komuna, institucionet tona janë takue me Bordin e KEK-ut dhe shpresoj që kanë bisedue edhe për këtë problematikë. Kishte me qenë mirë që pas kësaj përgjegjeje me pasë edhe një takim Ekzekutivi i Komunës, Kryetari i Komunës me stafin e vet, me pa që do të thotë se qëndrimi ynë nuk ka ndryshue, qarkullimi i qytetarëve është urgjentë dhe i përditshëm, kështu që nuk ka kohë shumë për lojë ping pongu jo e kemi mirë ne, jo e ka mirë ai. Përndryshe, ne duhet me i bë padri edhe si institucion, edhe si qytetarë se ata e kanë pengue qarkullimin e qytetarëve dhe kanë shkaktue shpenzime shtesë për qytetarët për me kalue nëpër 2,3 Komuna, për me mund me gravitue në Komunën e vetë. Unë iu sugjeroj qytetarëve që të bëjnë padi për krejtë këtë periudhë që po iu shkaktojnë vështirësi qytetarëve që KEK-u, të merrë përgjegjësi për këto gjëra. Padi mund të vonohet, por jam i bindur se kanë me pasë këta lëndën e fituar edhe për hir të interesit dhe për shkak të shpenzimeve shtesë që po u shkaktohen. Në këtë drejtim është mirë të thirret një takim urgjentë. Në rast se është e nevojshme prapë me u thirrë një takim urgjentë i Kuvendit që me pa se cila është zgjidhja përfundimtare dhe çka mund të bëjmë ne.

**Jeton Mjekiqi** – Ne e kemi nxjerrë një rekomandim si Kuvend, por edhe si banor i asaj ane nuk e kemi në plan me ua lënë veç qysh po dojnë të KEK-ut. Tash, prej 21 anëtarëve po dojnë me na shkelë një vendim, një kërkesë tonën, edhe të qytetarëve dhe të Kuvendit, është e padrejtë, kështu që nuk e kemi në plan me i ikë atij rekomandimi që e kemi nxjerrë dhe ia kemi dërgue si Kuvend Komunal.

**Lulzim Preniqi** – Unë si punëtor i asaj minjere për rrugën në fjalë nëse, KEK-ut i pengojnë këto veturat tona që janë andej atëherë ato makina të rënda që enden çdo ditë prej Bardhit në Kosovën B dhe në Kosovën A nëpër qytet dhe nuk janë duke na penguar neve, atëherë çka jemi ne duke i penguar ata. Të gjitha ato mjete çdo ditë udhëtojnë prej Mirashit, prej Bardhit në Kosovën B dhe në Kosovën A.

**Kryesuesja** – Ne i qëndrojmë prapa rekomandimit të nxjerrë dhe është kërkesë e anëtarëve të Kuvendit që në mënyrë urgjente me kërkue dhe me shqyrtue edhe një herë përgjegjen që e ka dhënë KEK-u, sepse ne i qëndrojmë prapa banorëve të fshatit Graboc dhe Shipitullë, nuk lejojmë asnjë sekond me u ndje vetëm, as me u keqtrajtuë në këtë mënyrë.

**Nënkryetari i Komunës** – Është shumë e vërtetë që për vite të tëra KEK-u, ka shkaktue problematika të ngjashme, është ende duke vazhdue dhe do të vazhdoj ende. Ne jemi në krah të banorëve, jo vetëm të Grabocit por edhe të Shipitullës, Hades dhe do të kemi edhe të Sibocit, banorëve të asaj zone të përfshirë në kuadër të aktiviteteve që i zhvillon KEK-u, në atë zonë. Mendoj se ne nuk duhet të ndalemi sepse me vështirësi të madhe e kemi marrë këtë përgjegje nga ana e KEK-ut, se në takime jozyrtare ata të gjithë e lejojnë, por kur duhet me shkruë nuk e shkruan askush, prandaj edhe e kanë dhënë përgjegjen negative. Po ashtu, sikur të ishte në kompetencat e këtij Kuvendi dhe Ekzekutivi, unë jam shumë i bindur se asnjë nuk do të ishte kundër, vendimin sot do ta kishim nënshkruë cili do prej neve që e kishte pasë kompetencën për

sigurimin e qarkullimit të lirë të qytetarëve të kësaj ane. Takimet duhet të vazhdojnë prapë dhe unë them për përgjegjësi të plotë se në një takim që isha prezentë vetë në fillim të vitit të kaluar një prej kërkesave tona ka qenë edhe rruga sepse në bazëtë Ligjit për shpronësim dhe të Ligjit për aktivitete minerare dihet që operatori 5 vite përpara duhet ti njoftoj banorët për zhvendosje, e jo në momentin e fundit qysh kemi ardhë tash në këtë pozitë sepse ajo rrugë dihet kur është bërë para 15, ose 16 viteve. Është ndarë rruga që e përmendi z.Enver, që kemi kalue përmes Hades, që kanë qenë shiritat 10 metra prej rrugës kryesore dhe na është bërë rruga përmes Lajthishtës. Për këto vite që unë i kam 5 herë më është ndërruar drejtimi për me ardhë në Obiliq, që kanë me ndodhë ende ndryshime të tilla. Sido që të jetë ne nuk duhet të ndalemi, por duhet të jemi unik për hir të qytetarëve të asaj zonë sepse është zonë më e prekur jo në nivel të Komunës së Obiliqit, por në nivel vendi.

**Xhelal Krasniqi** – Besoj se i keni parë fillimet e fundit nga Termocentralet e KEK-ut, për gjendjen shqetësuese nga ndotja që nxjerrin këta tymtarë, por nuk ka nevojë ndoshta për filmime që të dëshmohet se sa e rëndë është gjendja, pasi ndotjen nga Termocentralet e shohim dhe e përjetojmë çdo ditë secili nga ne. Me dt.30 nëntor i pata sjellë në Kuvend shqetësimet e ambasadës suedeze së bashku me një OJQ vendore ku patën ngritë alarmin nga ky rrezik duke kërkuar nga Drejtoritë për ambient dhe inspeksion që të jenë 24 orë në monitorim dhe në asnjë mënyrë të mos bëjnë kompromis me ndotje sepse direkt po ndikohet edhe në shëndetin e qytetarëve. Nga atëherë gjendja vetëm se është përkeqësue dhe tani lirimi i grimcave të rrezikshme është edhe në nivel më të lartë. Ndërkaq, në reagimin e KEK-ut lexova përgjegjen që kjo korporatë kishte bërë dhe kjo deklaratë për mendimin tim është puro populliste që rëndon edhe më shumë gjendjen emocionale sepse me fjalë nuk përmirësohet gjendja dhe me kërkim falje. Mendoj se duhet të ketë investime direkte në përmirësimin e cilësisë së ajrit, që e kemi thënë edhe atëherë dhe po e përsërisë prapë që edhe vendet më demokratike në fillimet e tyre të zhvillimeve që i kanë pasë kanë bërë kompromise me ambientin dhe kompromise të ndryshme. Mirëpo, asnjëherë, në asnjë situatë pafundësisht për derisa Kosova A është e ndërtuar 20 vite më heret dhe bën ndotje përgjysmë më pak se sa Kosova B, që është 20 vite më e re. Unë kërkoj prej Drejtorisë së ambientit dhe inspeksionit që 24 orë të monitorohet dhe mos të pësojnë qytetarët e Obiliqit sepse preventivë, ose parandalimi i ndotjes kishte me qenë më pak e kushtueshme për qytetarin se sa shëndeti ku realisht çdonjeri prej neve kemi dikend që është prekur ose me sëmundje kancerogjene, ose me sëmundje të frymëmarrjes. Prandaj, ti kthejmë sytë edhe një herë nga këta 2 tymtarë sepse ne i gëzohemi punësimit dhe të mirave tjera, që na i sjellë përmes këtij kanali, këtij elektriciteti megjithatë, me shëndetin e qytetarëve nuk duhet me bë kompromis.

**Nënkryetari i Komunës** – Janë duke e monitorue dhe ka reagime.

